

COVID-19 | Maatregelen | 26/27/2021

Albanees | Vertaald uit het Nederlands

Masat që merren nga 26 korriku

Hyrje

Qeveria ka vënë rregulla për të ndaluar koronavirusin. Respektoji rregullat! Kështu ti nuk sëmuresh, apo nuk mund të sëmuresh asnjëri. Policia mund të të kontrollojë.

Vini re: Disa qytete/bashki dhe komuna kanë rregulla shitesë. Shiko faqen e internetit të qytetit/bashkisë apo të komunës.

Rregullat shumë të rëndësishme për në verë

- Është mira të vaksinohesh. Sa më shumë njerëz të jenë vaksinuar aq më shumë siguri ka për të gjithë ne.
- Laji shpesh duart e tua me ujë dhe sapun!
- Nëse je i/e sëmurë apo ke simptoma, atëherë rri në shtëpi dhe kontakto mjekun tënd të familjes!
- Nëse nuk je vaksinuar akoma dhe nëse shkon në një vend ku ka shumë njerëz, atëherë bëje vetë një test! Një test që bëhet vetë mund t'a blesh në farmaci.
- Është mira t'a lësh të takohesh me të tjerë përjashta.
- Është mira t'a lësh të takohesh me të tjerë në grupe të vegjël.
- Nëse në grupin tënd janë të gjithë të vaksinuar, atëherë ju nuk duhet të mbani një maskë për gojë.
- Ajros mirë : hapi dritaret!
- Vazhdo të mbash 1,5 metra distancë deri sa të jetë vaksinuar shumica e njerëzve/popullsisë.
- Bëj kujdes për sigurinë edhe gjatë pushimeve! Informohu mbi rregullat!

Të shkosh në një qytet apo shtet tjetër

Në Belgjikë :

- Lejohet të udhëtosh kudo.
- Nëse ti përdor transportin publik (autobus, tramvaj apo tren) dhe nëse ti ke moshë më të madhe se 12vjeç :
 - atëherë ti duhet mbash një maskë për gojë. Kjo është e detyrueshme.

Udhëtime jashtë shtetit :

- Është mira të mos udhëtosh jashtë Bashkimit Evropian.

- Nëse udhëton jashtë shtetit, atëherë janë 3 kode me ngjyra :
 - Kuq: rajon ose shtet ku ti ke një rrezik të madh për koronavirus. Është mira të mos udhëtosh për atje.
 - Portokalle: rajon ose shtet ku ti ke një rrezik të mesëm për koronavirus. Është mira të mos udhëtosh për atje.
 - Jeshil/ e gjelbër: rajon ose shtet ku ti ke një rrezik të vogël për koronavirus. Por ti mund të udhëtosh për atje.
 - Shiko tek faqja e internetit <https://www.info-coronavirus.be/nl/kleurcodes-per-land/>.
- Shiko në <https://diplomatie.belgium.be/> se cilat rregulla janë në shtetin ku ti do të shkosh!

Çertifikata COVID

- Nëse ti udhëton ti mund të kërkosh një çertifikatë COVID. Kjo është e detyrueshme në shumë shtete.
- Ka tre lloje çertifikatash
 - Çertifikatë e vaksinimit : ka së paku 14 ditë që ti je vaksinuar plotësisht.
 - Çertifikatë e testit : ti ke një test negativ për koronavirus (ka maksimumi 72 orë).
 - Çertifikatë e shërimit : ti ke pasur kohët e fundit koronavirus (jo më tepër se para 180 ditësh).
- Këto çertifikata mund t'i marrësh në <https://covidsafe.be/>.
- Shiko/pyet në <https://mijngezondheid.be> nëse duhet të bësh një test para nisjes.

Nëse kthehesh nga jashtë shtetit

- Ishe në udhëtim jashtë shtetit për më gjatë se 48 orë?
 - Plotëso formularin në: <https://travel.info-coronavirus.be/nl/public-health-passenger-locator-form> para se të kthehesh në Belgjikë!
 - Nëse vjen nga një zonë e gjelbër/jeshile apo portokalle, atëherë nuk duhet të bësh test dhe nuk duhet të futesh në karantinë.
 - Vjen nga një zonë e kuqe në Bashkimin Evropian?
 - ▶ Nëse ke një çertifikatë e vaksinimit ose një çertifikatë e shërimit, atëherë ti nuk duhet të futesh në karantinë apo të bësh një test.
 - ▶ Nëse nuk ke një çertifikatë e vaksinimit ose një çertifikatë e shërimit dhe nuk ke një test negativ për koronavirus të bërë maksimumi para 72 orësh, atëherë ti duhet të bësh një test në ditën 1 ose 2 pasi je kthyer në shtëpi pas udhëtimit. Nëse testi yt është negativ, atëherë ti lejohet të dalësh nga karantina kur të marrësh rrezultatit. Fëmijët nën 12 vjeç nuk duhet të bëjnë test.
 - Vjen nga një zonë e kuqe jashtë Bashkimit Evropian?
 - ▶ Nëse ke një çertifikatë e vaksinimit ose një çertifikatë e shërimit, atëherë ti duhet të bësh një test në ditën 1 ose 2 pasi je kthyer në shtëpi pas udhëtimit. Nëse testi yt është negativ, atëherë ti lejohet të dalësh nga karantina kur të marrësh rrezultatit. Fëmijët nën 12 vjeç nuk duhet të bëjnë test.
 - ▶ Nëse nuk ke një çertifikatë e vaksinimit ose një çertifikatë e shërimit, atëherë është e detyrueshme të futesh 10 ditë në karantinë. Bëj një test në ditën 1 ose 7 pasi je kthyer në shtëpi nga udhëtimi.
 - ▶ Ka disa shtete për të cilat kjo nuk vlen. Këtë listë e gjen në <https://www.info-coronavirus.be/nl/kleurcodes-per-land/>.

- Nëse vjen nga një zonë me rrezik shumë të madh, atëherë
 - ▶ Një listë të këtyre zonave e gjen në <https://info-coronavirus.be/nl/hoog-risico-landen/>.
 - ▶ Nëse ky është një shtet jashtë Bashkimit Evropian atëherë :
 - > Është e detyrueshme të futesh për 10 ditë në karantinë. Kjo vlen për të gjithë.
 - > Duhet të bësh test në ditën 1 dhe 7 pasi je kthyer në Belgjikë.
 - ▶ Nëse ky është një shtet brenda Bashkimit Evropian ose Zonës Schengen dhe :
 - > Nuk ke çertifikatë vaksinimi.
 - + Atëherë bëj test në ditën 1. Nëse ke tashmë një test negativ të bërë para ardhjes në Belgjikë, atëherë ky test lejohet të jetë bërë jo më shumë se para 72 orësh.
 - + Pastaj bëj edhe një herë test në ditën 7.
 - + Nëse një test është pozitiv, atëherë ti duhet detyrimisht të futesh 10 ditë në karantinë.
- Vini re: ty mund të të vihet një gjobë prej 250 eurosh nëse nuk e bën këtë.

Punë

- Është mira të punosh nga shtëpia.
- Nëse ti shkon në punën tënde për të punuar, atëherë
 - Ti duhet të vendosësh/mbash një maskë për gojë.
 - Ajros mirë : hapi dritaret !
- Nëse ke pyetje, merr informacione nga shefi yt.

Dyqanet

- Dyqanet janë hapur.
 - Nëse hyn në dyqan, atëherë dizinfektoi më parë duart e tua!
 - Vendos/mbaj një maskë për gojë! Kjo është e detyrueshme.
- Ka tregje (tregjet hapur).
 - Në treg lejohet të shkoni në një grup prej tetë personash. Fëmijët nën 12 vjeç nuk llogariten. Mbjaj 1,5 metra distancë me grupet e tjerë!
 - Lejohet të hash apo të pish në treg.
- Dyqani i natës është hapur deri në ora 01:00 e natës.
- Berberët/floktoret dhe profesionet e tjerë jomjeksor të kontaktit (të afërt) janë hapur. Për shembull: pedikyre, specialistët e bukurisë.

Hotel restorant kafe

- Kafetë dhe restorantët janë të hapur nga ora 05:00 e mëngjesit deri ora 01:00 e natës.
 - Lejohet të ulesh në tavolinë me maksimumi 8 persona bashkë. Ose me njerëzit me të cilët ti bashkëjeton. Fëmijët deri dhe përfshi 12 vjeç nuk llogariten.
 - Ti duhet të rrish ulur pranë tavolinës! Ti nuk duhet të mbash maskë për gojë.
 - Nëse duhet të shkosh në WC ose për të paguar, atëherë duhet të mbash një maskë për gojë.
 - Lejohet të ushtrosh një sport/lojë në kafe, për shembull bilardo. Por duhet të mbash një maskë për gojë.

Kontakt social

- Nëse fton dikë në shtëpinë tënde, atëherë
 - lejohe të presësh në ambjentet e brendshme 8 persona në të njëjtin moment.
 - Fëmijët deri dhe përfshi 12 vjeç nuk llogariten.
 - Në kopësht/oborr lejohe të presësh më tepër njerëz.

Lëvizje / aktivitet fizik

- Nëse bën sport në një klub apo shoqatë atëherë:
 - Kjo lejohe në grupe prej maksimumi 100 persona.
 - Rrini sa më tepër të jetë e mundur në grupe prej tetë personash. Ose në nje grup me njerëzit me të cilët bashkëjton. Fëmijët deri dhe përfshi 12 vjeç nuk llogariten.
 - Nëse nuk mund t'i bësh aktivitetet në grupe prej 8 (për shembull një ndeshje futbollit), atëherë lejohe të formosh grupe më të mëdhenj.
 - Duhet gjithmonë të jetë i pranishëm një trajner apo shoqërues.

Koha e lirë

- Lejohen aktivitete/evenimentë apo shfaqe. Për shembull: teatër, ndeshje të sportistëve profesionistë apo koncerte.
 - Këta lejohen me maksimumi 2000 persona në ambjentet e brendshme dhe 2500 persona përjashta.
 - Lejohet të shkoni në një eveniment apo në një shfaqe me një grup prej tetë personash. Ose me njerëzit me të cilët bashkëjton. Fëmijët deri dhe përfshi 12 vjeç nuk llogariten. Mbani 1,5 metra distancë me grupet e tjerë.
- Aktivitetet e organizuar (për shembull një klub apo shoqatë) lejohen me maksimumi 100 persona.
 - Duhet gjithmonë të jetë i pranishëm një trajner apo shoqërues.
 - Rrini sa më tepër të jetë e mundur në grupe prej tetë personash. Ose me njerëzit me të cilët bashkëjton. Fëmijët deri dhe përfshi 12 vjeç nuk llogariten.
 - Nëse ti nuk mund të bësh një aktivitet në grup prej 8 (për shembull një ndeshje futbollit), atëherë lejohe të formosh grupe më të mëdhenj.
- Çfarë rri mbyllur?
 - Diskotekat
 - Sallat e vallëzimit

Besim fetar

- Shërbimet fetare lejohen
 - Këta lejohen në ambjentet e brendshëm me maksimumi 200 persona, ose përjashta me maksimumi 400 persona.
 - Fëmijët deri dhe përfshi 12 vjeç dhe shërbyesi fetar (për shembull : prifti apo imami/hoxha) nuk llogariten.
 - Rrini sa më tepër të jetë e mundur në grupe prej tetë personash. Ose në një grup me njerëzit me të cilët bashkëjton. Fëmijët deri dhe përfshi 12 vjeç nuk llogariten.

Çerdhe dhe shkolla

- Çerdhet janë hapur.
- Fëmijët mund të kthehen në shkollë. Shkolla jote të jep informacione të mëtejshëm.

Inkurajim / nxitje

Këta rregulla janë të rëndësishme për shëndetin e gjithësecilit. Gjithësecili duhet t'i respektojë ato.

Faleminderit që do të bësh këtë gjë! Së bashku, ne e ndalojmë koronavirusin.